



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr.141, datë 18.07.2024

PËR
“MIRATIMIN E RAPORTIT TË VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL,
TË DREJTUESIT TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË APELIT TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM,
ZOTIT GENTI XHOLI”

Mbështetur në nenin 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës, nenet 159, 164, pika 8, 184, germa “dh”, 189, pika 1, germa “a”, 190 të ligjit Nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, nenin 96 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregulloren “Për vlerësimin etik dhe profesional të drejtuesve të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm”, si dhe pasi u njoh me raportin e përgatitur nga relatori, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Raportit të vlerësimit etik dhe profesional, të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, zotit Genti Xholi duke e vlerësuar si më poshtë:
 - a. Aftësitë drejtuese dhe organizative – “Shumë mirë”;
 - b. Aftësitë komunikuese – “Shumë mirë”;
 - **Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shumë mirë”.**
2. Raporti vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar vetëm për shkelje të rënda procedurale.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë në përputhje me nenin 95, pika 9 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.

5. U shpall në Tiranë, sot më 18.07.2024.



KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Moisi Duda